



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1993/2 prot

Datë 15.08.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr. REF-75634-07-20-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh Riveshje dhe sistemim asfaltim nyja Shkozet mbikalimi Plepa*”, me fond limit 1,346,516.84 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 01.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomike “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF
Rruga e Kavajës, ish-Parku, pranë "Tregut 100 Vitrinat",
Kulla C, Shkalle 2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
“Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë

Në datën 14.08.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. protokollin 1993, datë 14.08.2023 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF, për procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr. REF-75634-07-20-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh Riveshje dhe sistemim asfaltim nyja Shkozet mbikalimi Plepa*”, me fond limit 1,346,516.84 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 01.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur

nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF, kundërshton me anë të ankesës me nr. 1993 prot., datë 14.08.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “G.B Civil & Margarita Kodra” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST, konkretisht;

*1. Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.3. BOE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë personelin kryesor sipas përcaktimeve në DST. Nga BOE stafi teknik dhe profesional i deklaruar i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate në këtë procedurë prokurimi janë të deklaruara në një objekt tjetër në proces ndërtimi pranë Autoritetit Kontraktor. Bazuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, dhe në Deklaratën e Operatorit *stafi teknik i shoqërisë dhe stafi profesional i deklaruar i Operatorit nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues”.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 15.08.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro